REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës:	2022:026945
Datë:	01.04.2022
Numri i dokumentit:	02870959

P.nr.52/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzana Rudi , në çështjen penale kundër të pandehurit SH.D nga Kaçaniku, i akuzuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.198/2022 të datës 23.02.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar publik, më datë 02.03.2022, në praninë e Prokurorit të Shtetit Avdullah Abedini, të pandehurit dhe mbrojtëses sipas detyrës zyrtare – Avokate Mimoza Kuka-Bushi, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 01.04.2022 përpiloi këtë:

A K T GJ Y K I M

I pandehuri: SH.D nga Komuna e Kaçanikut, i lindur me datë ..., nga i ati E..., e ëma Sh... e gjinisë M..., me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, gjendej në paraburgim nga data 09.02.2022 deri më datë 02.03.2022

2022:036879

ËSHTË FAJTOR

Më datë 09.02.2022, në ora 15:50, në rrugën "Ismet Jashari" në Kaçanik, i pandehuri me qëllim të frikësimit ose shkaktimit të ankthit i kanos seriozisht të dëmtuarit, A. D. dhe Xh. H., në atë mënyrë që derisa të dëmtuarit kishin qenë duke qëndruar në lagjen e tyre aty shkon i pandehuri ku fillimisht i ofendon me fjalët më banale e pastaj i njëjti shkon tek shtëpia e tij dhe me përdorimin e forcës ia merr sëpatën prindit të tij nga dora i cili kishte qenë duke prerë drunjë, mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë truporë dhe ju kishte vërsulur fillimisht të dëmtuarit A. D. me sopat duke dashur që ta godas dhe duke e kanosur me fjalët *"Kam me ju pre"* e pastaj kishte shkuar edhe në drejtim të të dëmtuarit Xh. H. duke e kanosur me fjalët kërcënuese se *"kam me ju pre, kam me ju vra"* me ç'rast kjo kanosje ka shkaktuar shqetësim frikë dhe pasiguri tek të dëmtuarit dhe familjet e tyre.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit lartcekur dhe neneve 2, 17, 38, 39, 42, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së, 359, 360, 361 dhe 365 të KPPK-së, e:

GJYKON

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 100 ditëve (Njëqind ditëve), i cili do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në dënimin e shqiptuar i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data 09.02.2022 deri më datë 02.03.2022.

II. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

III. I pandehuri lirohet nga shpenzimet e procedurës dhe fondit për kompensimin e viktimave të krimit.

2022:036879

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.198/2022 të datës 23.02.2022 për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 2 të KPRK-së, dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtor dhe t'i shqipton sanksion penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 02.03.2022.

Pas leximit të aktakuzave, i pandehuri e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, i ka premtuar Gjykatës se nuk do të përsëris veprime të tilla në të ardhmen.

Mbrojtësja e të pandehurit ka deklaruar se e mbështesim pranimin e fajësisë pasi që i njëjti pranim është bërë në baza vullnetare duke qenë i njoftuar për pasojat ligjore dhe rrethanat lehtësuese të cilat i parasheh ligji, duke i propozuar gjykatës që me rastin e shqiptimit të dënimit të ketë parasysh rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajësisë, pendimi i tij i thellë i shprehur në të gjithë procedurën, premtimin se i njëjti në të ardhmen nuk do të përsëris vepra penale, prandaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtit ti shqiptohet një dënim sa më i butë i paraparë me ligj.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza ligjore nga neni 248 të KPP-së, për pranimin e fajësisë së të pandehurit, duke i propozuar gjykatës që me rastin e caktimit të llojit të dënimit, si rrethanë lehtësuese të merr pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese të merr peshën e veprës penale duke pasur parasysh faktin se në këtë rast të dëmtuar janë dy persona, e po ashtu në momentin e kryerjes së veprës penale ka pasur një mjet në dorë.

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë në shqyrtim fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 4 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht; - pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga

2022:036879

Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 4 lidhur me paragrafin të KPRK-së, si në mënyrë, datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, konform neneve 69, 70, të KPRK-së gjykata vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale, pendimin për veprën penale të kryer, premtimi se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tjera, dhe gjendja e dobët ekonomike, ndërsa si rrethana renduese nuk gjeti.

Sipas bindjes së Gjykatës dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë, minimumin dhe maksimumin e dënimit dhe gjendjes ekonomike të pandehurit është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprave penale dhe me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për udhëzimin në kontest civil të palëve të dëmtuara është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPP-së.

Konform nenit 453 par 4 të KPPK-së, i pandehuri lirohet nga detyrimi i pagesës për shpenzimet e procedurës penale, shpenzimet e paushallit gjyqësor si dhe taksen për kompensimin e viktimave të krimit, ngase do të rrezikohet gjendja materiale tij dhe familjes.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

2022:036879

P.nr.52/22 datë 01.04.2022

Procesmbajtësja Gjyqtari

Suzana Rudi Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

2022:036879